

Subjekti “*gjoni*” shpk
Kraste- Bulqize

RAPORTI TREGUESVE TE RALIZUAR
GJATE VITIT 2017 SI DHE PROJEKTI TEKNIKO
EKONOMIK SHFRYTEZIMIT
TE MINERALIT TE KROMIT PER VITIN 2018
NGA Hz.(*PANELI*) 1260 - 1363
LEJE MINERARE 1326
MINIERA KROMIT THEKEN
BASHKIA BULQIZE
QARKU DIBER

L e n d a : *Kerkese per miratimin e programit vjetor (2018)*

Leja Minerare nr. 1326 dt 21.02.2009

Objekti **“Theken galerite nr.27,26 dhe 15“ (Paneli 1260 deri 1363)**

Vend-Burimi - Kromit – THEKEN

Drejtuar : AGJENCISE KOMBETARE TE BURIMEVE NATYRORE

(AKBN-se)

Tirane

Shoqeria tregtare **“Gjoni”** shpk, gjate vitit 2017 ka punuar ne objektin minerar te kromit gal, nr.27,26 ,15 (paneli +1260 deri +1363) ne baze te lejes minerare per kete objek dhe programit te prodhimit te miratuar nga AKBN- ja per vitin 2017.

Punimet dhe prodhimi i mineralit te kromit gjate vitit te kaluar eshte perqendruar nivelin e galerise nr. 15 ne zonen e prerjeve -15.13 deri -11dhe me teper ne nivelin e galerise nr.26 ne zonen e prerjeve-III-V deri VII nga n/kati I pare e siper deri ne galerine nr.15. Punimet jane porjentuare drejt perendimit te objektit, sipas trupit Jugor I pare.Sistemi i shfrytezimit eshte perdorur ai tradicionale me shembje galeri n/kati, system ky I perdorur edhe me pare dhe qe kushtezon zbatimin e tije edhe sot.Nje rendesi shume e madhe i eshte kushtuar zbatimit me rigorizitet gjate proceseve te punes te rregullave te sig. teknik dhe mbrojtjes ne pune ,bazuar ne Rregulloren e Sig. Teknik per miniera dhe kariera.

Ne zbatim te nenit 59 dhe 69 pika b te ligjit **Nr.10304** dt.15.07..2010, ‘ Per sektorin Minerare ne Republiken e Shqiperise” dhe ne zbatim te urdherit nr.304 dt.13.04.2017, urdherit nr.202 dt 20.06.2017 shoqeria **“Gjoni”** sh.p.k me administrator z.**Jashar Gjoni** banues ne Tirane, person juridik me vendim gjykates se Tiranës dhe I regjistruar prane QKL-se Tirane paraqet kerkesen per miratimin e programit vjetor (rinovimin) te lejes minerare Nr.1326 dt 21.02.2009 per shfrytezimin e mineralit te kromit ne objektin **Gal.Nr.27,26 dhe 15 (paneli +1260 deri +1363).**

Vendburimi i Kromit Theken, njesia administrative Martanesh Bashkia Bulqize

Administratori.

(Jashar GJONI)

I - PJESA E PERGJITHSHME

I.- 1 Objekti i pajisur me leje minerare

Shoqeria 'Gjoni' Sh.p.k është pajisur me leje minerare nr. 1326 date 21.02.2009 për shfrytëzimin e celiqeve në panelin mes galerive nr. 27 (+1260) deri në nivelin e galerisë nr. 16 (+1363) të vendburimit të Theknes, rrethi Bulqizë, Qarku Diber. Objekti përfshihet midis profileve XIII deri -21 për trupin xeheror të kromit Jugor I parë dhe I dytë. Vendburimi është shfrytëzuar nga viti 1972 deri në vitin 1997, nga ish miniera Bater sektori Theken.

I.-2 Vendndodhja e objektit

Zona e marrë në shfrytëzim ndodhet në lindje të vendburimit të Theknes nën rrugën automobilistike Theken- Ballenjë, e hapur nga galeritë nr.27 dhe nr.15 nga kuota (+1260 deri në kuotën +1363) midis prerjeve III dhe -21 dhe e përcaktuar sipas koordinatave që jepen në hartën topografike të lejes minerare që shoqëron këtë program pune..

I.-3 Topografia dhe klima e zones

Objekti ndodhet në një terren malor të thyer me kuota +1260 deri në +1363 m. Relievi i objektit bie në drejtim tejug- perëndim dhe është mjaft i thyer. Siperfaqja e objektit nuk është e mbuluar me pyll, nuk është tokë bujqësore, mbi të nuk ka vepra arti, argjaturë dhe vepra hidroteknike.

I.-4 Ndertimi gjeologjik i objektit dhe përshkrimi i trupit xeheror

Në ndertimin gjeologjik të objektit zona midis galerive 27 dhe 16 të vendburimit të Theknes marrin pjesë harburgitet, dunitet dhe shkëmbinjtë damarorë (piroksenitë dhe gabro). Përhapja, karakteristikat e ndryshme gjeomorfologjike dhe petrografike të tyre janë përshkruar në pjesën që vijon.

I.-5 Ndertimi gjeologjik i vendburimit

Në ndertimin gjeologjik të rajonit të vendburimit të Theknes marrin pjesë këta lloje shkëmborë: Dunitet, dunitet pak të serpentinzuara, dunitet piroksenitike, harburgite, harburgite pak të serpentinzuara, seria damarorë, trupi mineral dhe deluvionet.

Dunitet kanë përhapje të kufizuar, takohen në forme thjerrzash me shtrirje 35-70 m deri 120 m, trashësi 7-50. Zhvillohen me shtrirje të përgjithshme Veriperëndim-Juglindje me azimut shtrirje mesatar 290-310°. Ato kanë një shpërndarje jouniforme dhe takohen në mes të harbuciteve, me shkallë të ndryshme serpentinzimi me kalime graduale midis tyre. Dunitet janë shkëmbinje monomirale me ngjyrë jeshile ulliri ose në të çelët, me teksture masive dhe strukture kokrrizore të vogël të shpërndara jouniformisht.

Dunitet pak të serpentinzuara kanë përhapje të kufizuar dhe takohen në mes të harburgiteve me të njëjten shkallë serpentinzimi me kalime graduale midis tyre. Këto thjersa dunitike ruajnë në përgjithësi në shtrirje elemente të njëjta me ato të rajonit. Ata janë shkëmbinje të forta me strukturë kokërrvogël, teksture me forme të çrregullt të kristaleve.

Në këto dunitet dallohen pikezime të imta të kromshpinelitit aksesori. Në sipërfaqe ata paraqiten të alteruara në trashësi 1-2 cm.

Dunitet e serpentinzuara dallohen nga të mesipërmet për nga sipërfaqja me e vogël që zënë. Ato janë të alteruara. Kristalet e olivines janë të përshkuara nga rrjeta damarësh krizotili dhe antigoriti, të cilat pjesërisht janë të mbushura me grimca manjetiti dytesor.

Ngjyra e tyre eshte e gjelber,e gjelber e mbyllur gje qe iu jep shkembinjëve nuance te zeza.Ne disa raste dunitet e serpentinzuar pershkohen nga rrjete serpentine e tipit serpoft.Ne keto lloj dunitesh sasia e kristaleve te kromshpinelidit aksesor ndryshon nga dunitet me pikezime te rralla.Ne dunitet me sasira te medha kromshpinelidit aksesor ndryshon nga dunitet me pikezime te rralla.Ne dunitet me sasira kromshpinelitesh qe jane te vendosura jo uniformisht ne masen e shkembit,sasia e grimcave arrin 0.1-1.3%. Dunitet piroksentike jane lloje dunitike te tilla ne te cilen verehen 1-3-5% kristale te piroksenit. Ato jane takuar ne sasira te vogla dhe ne shkalle te njejte serpentinizimi me shkembinjte qe kontaktojne.Serpentina eshte rrjetore e tipit krizotil.ne masen e dunitëve piroksentike dallohen kromshpinelite aksesore ne forme pikezimesh te imta dhe te rralla,te shperndare ne menyre jouniforme.

Harcburgitet zene siperfaqe te medha dhe kane shkalle te ndryshme serpentinizimi. Kontakti i tyre me dunitet eshte i qarte,gradual,tektonik dhe i mbuluar.Harcburgitet jane me ngjyre te gjelber,te gjelber te mbyllur dhe te çelet dhe me fortesi 4-7.Nga ana tektonike jane te shkaterruara dhe te coptuara ne drejtime te ndryshme.

Harcburgitet pak te serpentinzuar kane perhapje me te madhe se ata te mesipermet dhe ndodhen po ne te njejtin vend.Jane pak te alteruara dhe kane fortesi me te madhe. Permbajtja e kristaleve te piroksenit luhatet 20-25 % me nje shperndarje jouniforme te tyre. Ato kane teksture masive dhe strukture kokrrizore te mesme.Kristalet e piroksenit jane me madhesi te ndryshme 2-6 mm dhe ne disa raste takohen fenokristale te tyre.Ne mase shkembore takohen pikezime te imta dhe te rralla te kromshpinelidit aksesor te shperndara jouniformisht.Kontakti i shkembinjve pak te serpentinzuar me ato te serpentizuara eshte gradual.Keta jane te ndotur me hidrokside hekuri.

Harcburgitet te serpentinzuar zene pjesen me te madhe te rajonit.ne perberjet e tyre marine pjese keto minerale : Olivina,Pirokseni,Kromshpineliti,Serpentina dhe rralle talku dhe kloriti.Ne siperfaqe jane alteruara ne thellesi 1-3 cm.

Kane ngjyre te gjelber me nuance te kuqerremte deri ne kafe te verdhe.Ne thyerje kane ngjyre te gjelber ne te erret.Sasia e kristaleve te piroksenit me madhesi 2-3 mm arrin ne mase 15-20 % .Ato formojne ne disa raste teksture brezore,por shpesh jane te shpendara ne menyre jouniforme.Shkalla e serpentinizimit e tyre eshte e ndryshme,eshte mjaft e zhvilluar tektonika shkeputese si ne shtrirje dhe ne renije.Ata kane strukture poikilitike.Serpentina paraqitet me strukture rrjetore dhe te ngopur me hidrokside hekuri.Shtrirja e pergjithshme e tyre eshte 290-300°. Ne masen e shkembit jane shperndare ne menyre jouniforme pikezime te rralla dhe te imta kromshpinelidit aksesor.

Serpentinitet takohen gjate prishjeve tektonive dhe ne kontakt me trupin mineral.Sipas mineraleve relike te mbetura nga shkembinjte meme dallojme dunitet dhe serpentinitet te harcburgiteve.Masa e serpentiniteve eshte e pershkruar nga damare te shumte krizotili me drejtime te ndryshme.Ata permbajne kokriza te shumta te kromshpineliteve aksesore si dhe magnetit dytesor te orjentuar net e njejtin drejtim duke i dhene shkembit nje teksture mikrobrezore.

Seria damarore perfaqesohet nga damare piroksenit te serpentinzuar me gjatesi 2- 15 m dhe trashesi 1-14 cm.Kane nje shtrirje qe nderpret shtrirejn e pergjithshme.Tektonika shkeputese eshte shume e zhvilluar. Depozitimet deluviale zene nje siperfaqe jo te madhe.Perfaqesohen nga copeza perioditi dhe dunitet me madhesi 0,3 -1. m.Coperat e shkembinjëve qe takohen jane te serpentinz-uara dhe te alteruara si dhe te ndotura me hidrokside hekuri.Trashesia e tyre varion 0.5-2 m dhe ne disa raste kontakti i tyre me shkembinjte rrenjesor nuk eshte i qarte.

I-6 Pershkrimi i trupit xeherore

Zona per te cilen eshte kerkuar miratimi i programit vjetor te punes per Lejen e shfrytezimit Nr 1326 ndodhet ne pjesen qendrore-perendimore te vendburimit Theken dhe eshte pjese e trupit xeherore Jugor i pare dhe i dyte dhe shoqeruesi i tije.

Ky trup ne kete pjese V.B eshte prezantuar ne disa galeri paralele, qe fillojne qe nga niveli i galerise nr 27 deri ne siperfaqe

Trupi xeherore Jugor i I^{te} ne kete pjese te V.B ka nje trashesi 0.8-3.1 m me nje trashesi mesatare 2.3 m dhe permbajtje te Cr₂O₃ ne kufijte 39-46 %.Morfologjikisht ai eshte podiforme pllakor dhe ne drejtim te thellesise vjen dhe zvoglohet gjate te renies duke kaluar ne natyre shtresore linzore. Trupi ka drejtim shtrirje gati V-Lindje Jug-Perendim, zhvillimi ne renie vjen duke u zvogeluar dhe zhytet ne drejtim te lindjes.

Nga dokumentimi i punimeve shtresore rezulton se trupi ka nje renie te forte jugore me kende qe luhaten ne kufijte 60°-65° dhe nje shtrirje veriperendimore 290°-310°.

Tektonika e vendburimit eshte mjaft e zhvilluar dhe dallohet si ajo e tipit gjatesor ashtu dhe ajo e tipit terthor.Me karakteristike eshte ajo e tipit terthor e cila takohet afersisht ne çdo 6-7m.

I-7 Te dhena te shkurtra per minieren

Objekti ne fjale qe zoteron leje administrativisht ka qene ne juridiksionin e minieres se kromit te Batres.Punimet ne kete objekt kane filluar me projekt hapje dhe shfrytezimi ne vitin 1967 dhe jane nderprere ne vitin 1997.Hapja e vendburimit per kete trup xeheror duke patur parasysh kushtet topografike dhe morfologjine e trupit xeherore eshte bere me punime horizontale nga siperfaqja por ne thellesi ka edhe dishenteri.

I-8 Punimet e kryera

Pjesa e vendburimit qe eshte marre me leje shfrytezimi eshte hapur me dy punime nga siperfaqja dhe perkatesisht: Galeria 27 me Z= 1660,6m deri ne nivelin e galerise nr. 16 (+ 1363)dhe gjatesi te ndryshme te tyre qe arrin deri ne rreth 1100 m.Ajo eshte hapur ne zonen midis profileve XIII deri ne lindje pr.-17, Galeria nr, 26 me kuote 1290 nga prerja XIII – -17, Galeria nr 15 me kuote 1330 qe fillon ne siperfaqe ne prerjen V-VII duke u degezuar ne te dy krahet majtas deri ne prerjen -17 dhe djathtas deri ne prerjen XI Ne te dy rastet e galerive eshte ndjekur trupi xeheror i kromit ne shtrirje dhe me pas me ane te shfrytezimit me galeri n/kati eshte shfrytezuar kjo pjese e vendburimit.

Ne rastet e punimeve shtresore kur ato kane shkuar sipas shtrirjes se mineralizimit jane dubluar me punime dytesore per tu shmangur nga ndikimet e hapsirave te vjetra.

I.9 LLogaritja e rezervave.

Per llogaritjen e rezervave gjeologjike te objektit jane marre ne konsiderate nje sere faktoresh gjeologjiko-morfologjik strukturore punimet e zbulimit te kryera ne object si dhe rrejeti i kryerjes se ketyre punimeve,shkalla e saktetise e provuar deri tani etj. Mbi bazen e tyre dhe punimeve mbeshtetese eshte bere gjeometrizimi i blloqeve ne prerje.Siperfaqet jane matur ne prerjet gjeologjike me kompjuter ne programin e autokadit.Per llogaritjet e metejshme si volumet,sasia dhe permbajtja e komponentit te dobishem jane perdorur metodat klasike.Permbajtja e komponentit te dobishem eshte llogaritur me menyren e ponterimit per cdo punim,siperfaqe mesatare dhe me ne fund per te gjitha vendburimin.Prerjet Vertikale te vedosura kryq me shtrirjen e structures ne pergjithesi,jane pranuar ata te ndertuara nga ish ndermarrjet gjeologjike te zbulimit.Per llogaritjen e volumit (ne m³) te blloqeve te rezervave jane perdorur formulat e meposhtme:

- Kh Koeficienti i humbjeve ne %:
- Rb Sasia e rezervave gjeologjike ne bllok,ne ton:
- Cb Permbajtja e komponentit te dobishem Cr₂O₃ ne bllok:
- Rn Sasia e rezervave gjeologjike ne bllok, ne ton:
- Cn Permbajtja e komponentit te dobishem Cr₂O₃ ne mineralin e prodhuar.

Trashesia mesatare eshte 1,3-2,2 m, Ne te dy drejtimet e shtrirjes, ate veri-perendimor dhe jug-lindor, verehet nderprerje e vazhdimetise se trupit per efek te mungeses se zbulimit, sidomos ne drejtim te renies, ne prerjet -9 eri -11. Azimuti i shtrirjes eshte 110-290°. Gjate ndjekjes ne shtrirje te structures,konstatohet prania e tektonikes shkeputese.

Nga punimet e zbulimit (shpimet) te bera nga ish ndermarrja Gjeologjike e Bulqizes dhe Burrelit, krijohet

idea, se kemi te bejme me strukturen mineralmbajtese me pamje pseudoshtresore e cila ne drejtim te Jugut dhe jug-lindjes, mund te mbyllet gjate renies se saje jugperendimore per te marre fuqine zhytja. Nga te dhenat e punimeve minerare dhe ature te zbulimit mineralzimi bie me kend renie nga 60-65 grade deri ne 70° trupat pesojne ndryshime te ketyre parametrave te renies dhe shtrirjes se trupit mund te ndodhin dhe per efek te tektonikes shkeputese te pasmineralizimit dhe shkalles se ulet te zbulimit. Mbi bazen e elementeve te trupit xeheror te fiksuar nga punimet e zbulimit (shpimet), galerite si gjatesi bloku te zbuluar eshte marre kufiri deri 30 ml, trashesi 1,3-2,2 m, gjatesi ne renie 7.5ml C₁ dhe 7,5 ml C₂ dhe peshe volumore 2.9- 3.8 ton/m³ e me lart ne funksion kjo te cilesise. Sasia e rezervave, qe sipas gjykimit tone, sipas intensitetit te punimeve i vleresojme te kategorise B, C₁ dhe C₂, respektivisht 80 ,70 dhe 35 % te sigurta, ne baze te interpretimit, llogariten ne 9 625 ton.

Tabela e llogaritjes se rezervave Trupi xeheror Jugor i pare (zona e prerjeve I-IX)

Tabela nr.3

3. ANALIZA E AKTIVITETIT TEKNIK DHE TREGUESVE EKONOMIKO-

– FINANCIAR TE REALIZUARA GJATE VITIT 2017

3.1-Te dhena per prodhimin e mineralit.

Ne Vitin 2017 subjekti "GJONI" SH.P.K. ka zhvilluar aktivitetin e saj minerar ne dy Traverbangje te Venburimit Theken te horizontit 1290 (Gal 26) dhe Gal.15 (+1330) ne nxjerrje te mineralit, kerkimin e blloqeve te mineralit, caliqeve te lena gjate shfrytezimit, dhe pregaditjen e tyre per shfrytezim. Si dhe nje volum te madh punimesh ne nenkat te II dhe III-te te galerise 26 dhe rruge kryesore te traverbangut 15 ne zonen e prerjeve -11 , -13-15. Me poshte po analizojme punen e kryer ne cdo traverbang dhe treguesit teknik te arritur prej secilit gjate ketij viti.

• Galeria Nr. 15

Ne zonen e prerjeve I-V ne kete nivel eshte pastruar unaza me nje gjatesi rreth 120 ml, unaz kjo qe ka shmangur punimin kryesor te trasportit (gal. 15) nga pozicioni fillestar. Kjo ka ardhur si pasoje e shembjes se punimit te vjeter ne kete zone dhe berjen e tij te pa kalueshem per qellime transporti. Seksioni I kesaj unaze ka qene 4,8 deri 5,2 m² dhe eshte mirembajtur sipas kushteve teknike per keto punime pasi do te sherbej si nivel transporti per punimet qe do te vazhdojne te hapen ne pjesen jugore te galerise nr, 15 ne zonen e prerjeve -9 , -11 deri -15 e me ne perendim, me qellim kerkimin e rezultateve te prerjes -13.

Gjate ketij viti eshte punuar ne nivelin kryesor ne perfundimin e nje degzimi majtas per kerkimin e rezultateve te prerjes -13 mbi nivelin e rruges kryesore te galerise nr. 15. Po ketu eshte ngritur nje fornell kerkimi por qe nuk takoi trupin xeheror te kromit. Punimet ketu u nderprene perkohesisht pasi vete rruga kryesore e galerise nr. 15 ne zonen e prerjeve III-I u demtua dhe si pasoje nuk u arrit perfundonin te gjitha punimet e kerkim-pergatitjes te parashikuara

Ne kete zone jane pregaditur dhe shfrytezuar pjese te lena gjate shfrytezimit (caliqe) te krahut mineral Jugor I pare kryesisht ne zonen e prerjes -13. Per vete karakteristikat e ketij trupi mineral duke patur nje gjatsi te konsiderueshme gjate renies dhe renie te forte, trashesi qe varion nga 0.8 ml -1.5ml, punimet minerare kane pasur si qellim ndjekjen e pjeseve tektonike dhe linjave te pasura me shenja kromi..Me ne verilindje ky trup eshte shfrytezuar dhe me pare nga ish miniera e kromit Theken ketu jane kryer punime kerkimi dhe me pas kemi pregaditur dhe shfrytezuar disa caliqe. Nje faktor i rendesishem qe na ka ndihmuar ne kete zone ka qene dhe fortesia dhe qendrueshmeria e shkembinjve Ne keto punime jane marre rreth 450 ton mineral me 40 % Cr₂O₃. Njekohesisht kemi punuar dhe ne traversen qe ndodhet 10 ml me ne jug te profilit -15

Prodhim Minerali	450 ton 40 %
Punime minerare	30 ml

- Nenkatii te (+16. ml nga rruga kryesore)
Ne kete nenkat gjate kesaj periudhe ka vazhduar ringritja pjesore e tij qe ne lindje te profile -15 deri ne profilin -13 ku me pas eshte vazhduar dhe balli i ketij ne drejtim te lindjes deri ne profilin -13 dhe me pas eshte lidhur me fushorin e nenkatit te II-te qellimi I te cilit eshte per rrugdalje per nenkat te II-te. Gjithsej 9 ml fushor dhe 8 ml furnel.(17 ml)

Por puna kryesore ne kete zone(ashtu sikurse edhe vitin e shkuar)eshte perqendruar ne zonen e profileve -13 ku eshte hapur fushori nga furnelet e Profilit -15 dhe ka vazhduar ringritja deri sa eshte lidhur me fushorin e vjeter ne profilin -13 eshte bere dhe ndjekja ne shtrirje dhe ngritje e trupit mineral te kromit me traversa me kundrejt hapsires dhe jane lidhur me te ne dy tre pika sipas niveleve te n/kateve .

Qellimi I ketyre ka qene pregaditja dhe shfrytezimi i nje pjese te rezervave te mbetura ne zona te caktuara ne keto nivele per shkak te trashesis se vogel te trupit te kromit te krahut Jugor I pare.

:

Prodhimi Minerali	250 me 37 %Cr2O3
Punime minerare	20 ml

- **TRAVERBANGU 26**

- a- Prerja I Punimet minerare per vitin 2017 ne kete pjese te objektit kane pasur kryesisht karakter kerkimi te nje pjese te trupit xeheror te shfrytezuar me pare gjate viteve te shkuara dhe pjeserisht edhe ne vitin 2017. Qellimi I kryerjes se ketyre punimeve ka qene kerkimi I trupit xeheror poshte tektonikes (pjesa e dubluar nga kjo tetonike). Kjo eshte menduar sin je pjese e pa shfrytezuar me pare dhe sipas interpretimit te bere duhet te ekzistojte si pjese e spostuar ne drejtim te veriut.Keto punime me karakter kerim-pergatitje u kryen pjeserisht por nuk takaun trupin e mineralizimit te kromit ato do te shumfishohen me punime te tjera kerkimore dhe me pas pergatitore dhe prerese me qellim pergatitjen per shfrytezim.Sasia e punimeve te kerkimit te kryera ne kete zone jane rreth 30 ml duke perfshire si ato horizontale edhe ato vertikale.
- b- Punimet ne prerjen V ne drejtim te perendimit,prerja VII ngan/kati I pare(ne ordinaten 40460) kane vazhduar me rimonte neper trup deri ne lartesine +6ml vertikalisht .Ne kete lartesi ka vazhduar nje n/kat I dyte me gjatesi rreth 15 ml ne drejtim te shtrirjes ne lindje. Ketu rreth 12 ml nga prerja V ne drejtim te prerjes VIIeshte ngritur nje rimonte neper trup. Keto punime do vazhdojne edhe per vitin 2018.
- c- Punimet minerare ne prerjet I-III-V Ne kete zone prerjesh punimet edhe per kete vit kane vazhduar ne shtrije dhe ngritje per tu lidhur punimeve te filluara dhe kryera vite me pare.. Punimet ketu kane karakter kryesisht pergatitor dhe shfrytezimi. Synimi kryesor eshte vazhdimi ne ngjitje I trupit xeheror mbi nivelin e rruges kryesore deri ne nivelin e n/katit te dyte e me siper. Keto punime kane ndjekur ne ngritje trupin e takuar me pare me disa shpime te kryera nga n/toka, shpime te cilet kane takuar trupin.Punimet e kryera ne kete prerje (prerjaV) kane bere dendesim te punimeve te vjetra per te mundesuar shfrytezimin e trupit xeheror te cilat e kane ndjekur ate ne drejtim te ngjitjst (prerja III-V)per ne shtrirje rreth 12 ml, per ta pergatitur ate per shfrytezim dhe shfrytezimin e tije gjate ketij viti.
- d- Ne vijim te kryerjes se punimeve minerare te reja gjate ketij viti eshte bere dhe ringritja e nivelit te galerise nr.26 nga prerja -9 deri ne prerjen -15 ne nje gjatesi rreth 110 ml.Gjate ringritjes eshte vendosur armatimi I ri ne zonat e demtuara, shtrimi I shinave pastrami I sterileve te shembura ne zona te vecanta te saj.

Prodhimi I kromit per kete periudhe kohe eshte bere kryesisht ne zonen e prerjeve V-I nga niveli I rruges kryesore te galerise nr. 26 deri ne galerine nr. 15. Per te realizuar treguesit e paraqitur ne kete program jane shfrytezuar krahas pastrimit te punimeve nga ringritje edhe duke perdorur dhe pastruar disa hinka te vjetra

te mbushura me mineral te perzier . Keto punime jane pastruar dhe seleksionuar me dore duke marre prej tyre nje sasi te konsiderushme prodhimi.

Ketu gjate rihapjes se n/kateve mbi rrugen kryesore te galerise nr. 26 si dhe rimontave neper mineral (jane armatosur dhe lidhur mes tyre ne pjese te lena pa shembur) eshte bere e mundur dhe vleresimi I gjendjes se hapsirave te vjetra dhe eshte punuar per pastrimin e disa hinkave te vjetra te shfrytezimit nga ku eshte marred he mineral I prodhuar me pare nga keto punime, vjeljen e pjeseve te mbetura pa shfrytezuat.

Ringritja e punimeve minerare.

Pergjithesisht ringritja e punimeve minerare eshte bere dora –doret qe ne kohen e venies ne pune te sektorit minerare.Linjat elektrike jane shkatrruar dhe jane larg sektorit te minieres. Ne kushtet e objektit te mungeses se energjise elektrike (tre fazore) deri tani kemi punuar me motorkompresor 10-12 m³ per te vene ne pune gjithë sektorin e licensuar. Tani me shtrirjen e linjes se energjise elektrike gjate vitit 2017 ne sector eshte instaluar nje elektro-kompresor 10 m³I cili do te furnizojte me ajer te komprimuar gjithë sektorin e licensuar.Subjekti ne cdo rast ka punuar duke zbatuar ne cdo hap rregullat e sig. teknik ne pune per te gjithë llojet e punimeve si ato te hapjes (kerkimit), pergatitjes, shfrytezimit,ringritjes e ajrimit te punimeve minerare.

Ringritja e punimeve eshte bere me qellim riaktivizimin e punimeve te kryera me pare ne kete zone me degzimin majtas te nivelit te galerise nr 26,qe eshte niveli baze I trasportit pas galerise nr. 15. Keto punime kene patur si qellim venien ne funksion dhe eficens te punimeve te braktisura te galerise nr. 26 si dhe pergatitjen per shfrytezim te mbetjeve teknologjike ne kete nivel deri ne nivelin e galerise nr.15, kryesisht ne zonen e prerjeve -13 -13-15 e me ne perendim.

Theksojme se shkembijte permes te cileve kalojne punimet minerare dhe ringritja ne nivelin e gal. 26(+ 1295m) jane me qendrueshmeri mesatare deri te mire ,punimet minerare ne shume vende kerkojne armature. .

Ne sasi ringritja ze rreth 45 % volumit dhe nga eksperienca qe kemi ne hapjen e punimeve minerare ne kete sektor, kohen e aktivizimit te tyre dhe gjatesine qe do te ringrihet i bie qe te kemi realizuar nje ringritje te plote ne rreth 50 ml punim.. Kjo ringritje ka seksionin fillestar te hapjes rreth 5,2 m².

Ne kete zone jane prodhuar rreth 5334 ton me 37.5-41 % mineral nga punimet dhe shfrytezimi

Prodhim Minerali	2341 ton me 38- 41% Cr₂O₃
Punime minerare	110 ml
Horizontale 70 ml	
Vertikale dhe te pjerrta	40 ml
Ringritje 70 ml	

3.2 Te dhena per ngritjen dhe hapjen e punimeve minerare .

Gjate periudhes qe kap rinovimi i kesaj leje duke u mbeshtetur ne projekt programin e miratuar me pare nga ana juaj dhe bazuar ne projektin baze te licensimit eshte bere ringritje pjesore e disa punimeve minerare dhe filluar hapja e punimeve minerare .

Gjate kesaj kohe jane hapur rreth 160 ml punime te reja kryesishte ne horizontin e galerise nr.26,-.15 e lart deri ne nivelin e galerise nr.16 dhe i perkasin kryesisht punimeve te llojit kerkim pergatitje .dhe prerese.Ndersa ne nivelin e galerise nr. 26 punimet jane kryer kryesisht ne dendesimin e punimeve te vjetra me qellim shfrytezimin e trupit xeheror ne keto zona.Ne hapjen e punimeve minerare kane punuar gjithsej 6 +1 punetore

3.3 Analiza e koston per punimet minerare per vitin 2017.

Ne baze te shpenzimeve te kryera ne hapjen e punimeve kapitale e pergatitore si dhe ne prodhim per vitin 2017,ne tabelen e meposhtme jepet kostoja e realizuar e detajuar per punimet minerare .

Realizimit te koston se punimeve pergatitore per vitin 2017,per 1 ml eshte dhene ne

Tabelen nr.7

3.4 Te dhenat per shitjen e mineralit

Prodhimi i realizuar gjate vitit kalendarik 2017 ne baze te kushteve reale te tregut eshte trasportuar eshte shitur brenda vendit per perpunim dhe ne eksport. Kjo ne perputhje me cilesine e produktit dhe luhatjes se cmimit ne treg. Nje pjese e produktit ndodhet ne objekt, nje sasi prej 951ton eshte akoma gjendje ne objekt per tu tregtuar me vone ne vitin e ardhshem 2018 kjo per shkak te luhatjeve te tregut cilesis se prodhimit .

3.5 Mbi investimet e kryera.

Gjate kesaj periudhe ne miniere jane kryer investimet e meposhtme ne zerin e ndertim-montimeve . Investimet jane kryer sipas programit ne projektin e ketij viti.

7.3 Investimet e kryera per vitn 2017 . Tabela nr.19

Nr	Zeri i emertimeve	Vlera Leke
1	Punime minerare kapitale	760 000
2	Punime te tjera	860 000
3	Investime per kushtet e punes punonesve	
4	Materiale te ndryshme	100 000
SHUMA	Leke	1 720 000

Parashikimi 1 720 000 realizimi 2 190 900 ne perqindje $2\ 190\ 900 / 1\ 720\ 000 = 127\ %$

3.6. Llogaritja e treguesve ekonomiko-financiar. Viti 2017

Meshtetur ne shpenzimet e kryera per prodhimin e nje toni mineral si dhe te ardhurat per periudhen licensuese te vitit 2017 jane arritur treguesit e me poshtem ekonomiko-financiare.

Ne kemi permendur me siper se kemi shitje te mineralit dhe shpenzimet operative jane si ne tablele.

Tabela Nr .10.

Nr	EMËRTIMI TREGUESVE	I	Njësia	TRE MUJORËT				VJETORI
				I	II	III	IV	
1	Prodhimi në natyrë	Ton	300	1200	360	1181	3041	
	Shitje viti 2017	Ton	438	-	1296	1045	2780	
2	Çmimi	\$ ton	-	-	-	-		
3	Kosto	\$ ton	97	97	97	97	97	
4	Të ardhuranga shitja	\$	-	-	-	-	980 460	
5	Shpenzime	\$					249 977	
6	Fitim bruto	leke						
7	Royalty (6%)	\$		7			2 226 774	
8	Fitimi para taksave	\$						
9	Tatim fitimi 15 %	\$						
10	Pagesa garanci investimi	\$					0	
11	Pag. Garanci rehabilit	\$					560	
10	Fitimi neto	\$						

Prodhimi dhe shitjet

Për vitin 2017 shitjet jane bere kryesisht Brenda vendit dhe nje pjese ne eksport, pasoj kjo e cmimit te arsyeshem dhe cilesis se produktit te nxjerre. Ketu duhet te thksojme se krahas mineralit te 'pasur' kemi takuar gjate kryerjes se punimeve edhe 'copra' me te varfere te cilat jene nxjerre dhe tregtuar kryesisht Brenda vendit duke i derguar ato ne fabrikat e pasurimit. Kjo ka qene nje sasi relativisht e vogel ne krahasim me eksportin. Kjo praktike do te ndiqet edhe ne vijim te punes sone duke shfrytezuar ne maksimum rezervat.

3.7 a - Konsumi i rezervave.

Gjate periudhes se ketij viti per realizimin e prodhimit te mesiperm (1050 t) jane marre prodhim nga mбетjet teknologjike ne nivelin e galerise nr. 15 dhe pjesa tjeter te asaj 26. Prodhimi I nxjerre nuk ka prekuar shume blloqet e llogaritur te rezervave (vetem 10 % e tyre jane prekur nga keto punime) pasi 'zonat' ku jane kryer punimet nuk ka patur rezerva te llogaritura dhe te perfshira ne bilanc.Ka patur raste ku jane marre disa 'pjesa tektonike te trupit' ne nivelin e galerise nr. 26 qe nuk perfshihen ne bilancin e rezervave pasi jane konsideruar humbje nga sistemi i shfrytezimit.

Sasia e rezervave te konsumuara duke ju referuar koeficientit te humbjeve i cile rezulton rreth 12 % dhe atij te varferimit 7 % eshte rreth 3622 ton. Tabela e konsumit te rezervave viti 2017. (Tab. Nr.11).

Nr	Trupi	Horiz.	Profili	Kat.	Sasi T	%Cr2O3	Kofic. H	Kof. V
1	Trupi Jug I	Gal 15	-13,-15	A -C1	1304	41-47	7	13.0
2	Trupi Jug I	Gal.26	III-VII	A-C ₁ -C ₂	1 404	47-38	7	15.0
	Shuma				2708	41-43		

3.8 b- Punimet minerare

Jane kryer punime per hapjen e pergatitjen e objektit kryesisht ne pjesen qendrore te tije,punime te reja kerkimi,ringritje, sistemime,riparime dhe pastrime te ndryshme duke synuar qe te realizojne:

- Krijimin e kushteve normale te punes per shfrytezimin sipas R T S per shfrytezimin e rezervave te mineralit te kromit midis profileve te pershkruara me siper.
- Krijimin e kushteve te favorshme te transportit te mineralit dhe sterilit si brenda ne miniere dhe ne siperfaqe.
- Sigurimin e kushteve te favorshme per paraprirjen e shfrytezimit te rezervave te tjera te celiqeve te vendburimit ne zonen e profileve ,-15,-5,ne nivelin e galerise nr. 15 dhe ne nivelin e galerise nr.26 eshte menduar te punohet ne zonen e prerjeve IX e me ne perendim deri tek prerja V,III.

4.Organizimi i punes

Per realizimin e treguesve te gjate vitit 2017 si ne punime minerare,prodhim dhe ringritje te ndryshme, shoqeria ka patur te punesuar mesatarisht 12 punonjes,te cilet kane punuar dhe ne brigade si komplekse,nga muaji Shkurt deri ne fundin e muajit dhjetor, 10, muaj,si ne tabelen e meposhtme nr.6 Tabela nr.12

Nr	Profesioni	TREMUIJORET E VITIT 2017				Mesatarja e vitit 2017
		I	II	III	IV	
1	Drejtues teknik	1	1	1	1	Numri mesatar vjetor 15
2	Minator + zjarmtar	2	2	2	2	
3	Armator + Punetore	8	13	13	13	
5	Totali	12	15	16	15	

Paga mesatare per vitin 2017 ka qene 22 500 leke per punojes ne muaj ose $22\ 500 \times 16 \times 12 = 4\ 320\ 000$ leke ose sebashku me shtesat per ushqim dhe sigurime shoqerore (+1 205 280) = 5 525 280 leke

5. Humbjet dhe varferimi

Treguesit e humbjes dhe varferimit duke pasur parasysh metoden e shfrytezimit te linzave xeherore kane qene rreth 7 %,ndersa varferimi pas seleksionimit me dore ne siperfaqe ka qene deri ne 15%.

6. PROGRAMI I PLOTE EKONOMIKO - FINANCIAR

PER VITIN 2018 I NDARE NE 3- MUJORE

6- 1 Punimet minerare te parashikuara te kryhen per vitin 2018.

